



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS LEPOSAVIQ

Numri i lëndës: 2020:113504

Datë: 14.06.2024

Numri i dokumentit: 05824081

P.nr.14/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË- Dega nw Leposaviq – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Qëndresa Tahiri - Islami, me bashkëpunëtoreshen profesionale Edita Koliqi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit D.M, për shkak të veprës penale: Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP-I.nr.142/2011 të datës 20.03.2017, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 27.05.2024, në mungesë të Prokurorit të Shtetit Albana Parduzi, të dëmtuarit M.Z të akuzuarit D.M dhe mbrojtësit të akuzuarit av.Dijar Dinaj, me datë 28.05.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 14.06.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit:

D.M, me nofkën “.....”, nga i ati, e ëma, e vajzërisë, i lindur me datë në Prijepole – Serbi, tani me vendbanim në fshatin, Komuna e Leposaviqit, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i dy fëmijëve, ish zyrtar policor, i gjendjes së mesme ekonomike, serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 23.08.2011 rreth orës 22:10 min. në fsh.Socanicë, Komuna e Leposaviqit, saktësisht tek pompa e benzinës “Dy vëllezërit”, ka përdorë armën, ku fillimisht i pandehuri i është drejtuar me fjalët “çka u bë” të dëmtuarit M.Z, ku i dëmtuari i është përgjigjur “asgjë, hajde largohu, çka

u bë me ty kështu”, dhe në atë moment i pandehuri ka nxjerrë armën e zjarrit, e ka repetirat, e ka kaluar armën e zjarrit në dorën e majtë duke e drejtuar në drejtim të kokës së dëmtuarit, kurse me dorën e djathtë ka nxjerrë baterinë ndriçuese me të cilën e ka goditur në regjionin e qafës,

-Me këtë ka kryer veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të neneve: 1, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 41, 43, 49, 50, 51, 52, 73,74, 75, 76 lidhur me nenin 375 par.1 të KPRK-së, dhe neneve: 364, 449, 452 të KPP-së, të akuzuarit, i:

S H Q I P T O N

- I. DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej njëmbëdhjetë (11) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej dy (2) viteve, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
- II. OBLIGOHET i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej tridhjetë (30) euro, në emër të fondit të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. Kërkesë pasurore-juridike nuk kishte.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP-I.nr.142/2011 të datës 20.03.2017, kundër të akuzuarit D.M, për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 27.05.2024, në të cilën ka prezantuar Prokurori i Shtetit Albana Parduzy, i dëmtuari M.Z, i akuzuari D.M dhe mbrojtësi i tij av.Dijar Dinaj.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, Gjyqtarja e vetme gjykuese e ka njoftuar të pandehurin lidhur me të drejtat e tij në këtë çështje penale dhe pasi që është bindur se i

pandehuri i ka kuptuar udhëzimet e gjykatës, të njëjtit i është dhënë mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë, ashtu që në këtë seancë i pandehuri lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se ndjehet fajtor dhe se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës.

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i propozoi gjykatës që të miratohet pranimi i fajësisë, ngase pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare, konform dispozitave ligjore të nenit 242 të KPP-së dhe ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

I dëmtuari M.Z, në deklaratën e dhënë është pajtuar me pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe ka shtuar se tërhiqet nga ndjekja penale, rasti ka qenë i qastit dhe nuk kanë asgjë në mes vete.

Mbrojtësi i të akuzuarit D.M, av.Dijar Dinaj lidhur me pranimin e fajësisë, i ka propozuar gjykatës që të miratohet pranimin e fajësisë, pasi është bërë në mënyrë vullnetare pas konsultimit të mjaftueshëm me të si mbrojtës.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i akuzuari, e në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, në këtë drejtim ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e fajësisë për të akuzuarin.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Vendimi mbi suspendimin nga vendi i punës i datës 24.08.2011; Memorandumet zyrtare; Raporti i oficerit me numër të rastit 2011/BE/210 i datës 23.08.2011; Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2011/BE/210 i datës 23.08.2011; Deklarata e të dëmtuarit e datës 23.08.2011; Deklaratat e dëshmitarëve I.M dhe D.L të datës 23.08.2011; Raporti mbi ecurinë e hetimeve; Shënimet zyrtare; Foto albumi nga shkresat e lëndës; Deklarata e të pandehurit e datës 15.09.2011, si dhe shkresat tjera të lëndës.

Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë të këtyre provave dhe pranimin të fajësisë, konsiderojmë se përtej çdo dyshimi është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, duke i' u tërhequr vërejtja të

akuzuarit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lartë, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari D.M ka kryer veprën penale: Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së, e për të cilën veprë është paraparë dënimi me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysht vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së. Gjykata, si rrethanë veçanërisht lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale nga i akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar, i njëjti ka treguar sjellje të mirë në gjykatë, si dhe faktin se nga kryerja e veprës penale ka kaluar një kohë mjaftë e gjatë, pothuajse trembëdhjetë (13) vite. Ndërsa, rrethana rënduese gjykata vlerësoj peshën dhe rrezikshmërinë e kësaj vepre penale.

Gjykata ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit sa i përket veprës penale: Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm, pasi që në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për zbutje në kuptim të nenit 75 par. 1 nën par. 1.3 të KPRK-së, pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë. Megjithatë, me rastin e zbutjes së dënimit janë respektuar kufijtë e zbutjes në kuptim të nenit 76 par. 1 nën par. 1.5 të KPRK-së. Në këtë situatë, atëherë gjykata, pasi i ka aplikuar dispozita e zbutjes së dënimit, në kuptim të nenit 49, 50, 51 dhe 52 ka shqiptuar dënimin me kusht me burgim në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) muaj, me kohë të verifikimit prej 2 (dy) viteve ndaj të akuzuarit.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 lidhur me par.1 dhe nenit 452 par. 1 të KPPK-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 par. 3 nën. par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 364, 452, 462 të KPPK-ës, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr.14/2018, të datës: 14.06.2024

Bashkëpunëtore profesionale
Edita Koliqi

Gjyqtarja e vetme gjyquese
Qëndresa Tahiri - Islami

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.